



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.04. 2010

V E N D I M

Nr.1219 , datë 07. 04. 2010

Për

“Miratimin e Rregullores për Portabilitetin e Numrit dhe Kërkesave Kryesore për Konsulencën e Portabilitetit të Numrit në Shqipëri”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Elda Topi , në mbledhjen e datës 07.04. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP,

mori në shqyrtim materialet shkresore të paraqitura nga Grupi i Punës të përbëra nga:

- “Rregullore për portabilitetin e numrit” (**Projektakti**);
- “Relacioni shpjegues mbi projektaktin” (**Relacioni**);
- Termat e Referencës dhe Kërkesat Kryesore për Konsulencën e Portabilitetit të Numrit në Shqipëri (**Termat e Referencës**);
- Dokumenti “Për Portabilitetin e Numrit” i datës 30. 10. 2008, i hartuar me asistencën e DDL;
- Projektregullorja për Portabilitetin e Numrit e datës 11.02.2009 (EBRD-DDL);
- Termat teknike dhe Komerciale për zbatimin e Portabilitetit të Numrit, miratuar me vendimin nr. 976 të Këshillit Drejtues të AKEP;
- Raporti i AKEP për komentet e palëve të interesuara, pas Këshillimit Publik për Portabilitetin e Numrit.;
- “Projekt-Vendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485” (**Projektvendimi**).

B A Z A L I G J O R E:

1. Shkronjat p) dhe r) të nenit 8 dhe neni 110 të ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;

3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
4. Vendimi nr. 931, datë 06.08.2009 i Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e dokumentit për këshillim publik për Portabilitetin e Numrit” (*Vendimi nr. 931*);
5. Vendimi nr. 976, datë 18.09.2009 i Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentit rregullator për këshillim publik “Termet Teknike dhe Komerciale për zbatimin e Portabilitetit të Numrit” (*Vendimi nr. 976*);
6. Vendimi nr. 1029, datë 16.11.2009 i Këshillit Drejtues të AKEP, “Për miratimin e publikimit të komenteve të palëve të interesuara për Portabilitetin e Numrit” (*Vendimi nr. 1029*).

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N :

7. Me vendimin nr. 936, është miratuar për këshillim publik dokumenti (projektregullore) “Për Portabilitetin e numrit” i hartuar nga ekspertët e AKEP në bashkëpunim me Konsulentin e projektit të financuar nga BERZH/BE.
8. Krahas dokumentit të miratuar me vendimin nr. 936, me vendim nr. 976, për këshillim publik është miratuar edhe dokumenti rregullator “Termet Teknike dhe Komerciale për zbatimin e Portabilitetit të Numrit”.
9. Me vendimin nr. 1029, miratohet vetëm publikimi i komenteve të palëve të interesuara dhe nuk u shqyrtua projektregullorja me qëllim miratimin e saj përfundimtar.
10. Me urdhërin nr.525,datë 04.01.2010, i ndryshuar me urdherin nr. 525/1, datë 17.03.2010, me qëllim përfundimin e procedurës së nisur është ngritur grupi i punës për administrimin e procesit të zbatimit të Portabilitetit të Numrit dhe Përcaktimin e Termave të Referencës dhe Kërkesat për Personelin Kryesor në përputhje me Dokumentat Standarde për procedurën e tenderit publik “sherbime konsulence”, e cila do të aplikohet nga AKEP për përzgjedhjen e Konsulentit që do të përgatisi termet teknike dhe komerciale lidhur me zbatimin e “Portabilitetit të Numrit” sipas përcaktimeve të vendosura në Rregulloren “Për Portabilitetin e Numrit”.
11. Grupi i punës i ngritur sipas Urdhërit 525, ndryshuar me urdhërin nr. 525/1, administron dokumentacionin e përfutur si rezultat i procedurës së ndjekur dhe pasi zhvillon një seancë dëgjimore me grupet e interesit arrin në variantin e propozuar të rregullores dhe termave të referencës të cituara në pikën e mësipërme 10.
12. Dokumentacioni i paraqitur, nga pikëpamja formale është në përputhje me përcaktimet e parashikuara në nenin 10/1 të Rregullores së Brendshme dhe ligjin nr. 8485. Ndërsa përmbajtja e akteve është në përputhje me kërkesat e neneve 87 dhe 88 të ligjit nr. 9918, si dhe praktikave dhe eksperiencave më të mira Rajonale dhe Europiane.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë, që:

Projektakti dhe termet e referencës, përmbushin kërkesat ligjore të përcaktuara në bazën ligjore referuese, bazuar në pikën 1 të nenit 114, pikën 1 të nenin 115 të ligjit nr. 9918 dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S :

1. Të miratojë Rregulloren për Portabilitetin e Numrit sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Të miratojë Kërkesat Kryesore për Konsulencën e Portabilitetit të Numrit në Shqipëri.
3. Të publikojë raportin e AKEP mbi komentet e palëve të interesuara gjatë këshillimit publik për Portabilitetin e Numrit, në faqen elektronike të AKEP www.akep.gov.al.
4. Rregullorja për Portabilitetin e Numrit të publikohet në faqen elektronike të AKEP www.akep.gov.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

A NETARET E KESHILLIT DREJTUES :

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**

RREGULLORE PËR PORTABILITETIN E NUMRIT

Kapitulli I Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton mënyrën dhe afatin kohor për zbatimin e portabilitetit të numrit, bazuar në nenin 88 të ligjit 9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2 Përkufizimet

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Operator” është një sipërmarrës, që është i autorizuar të ofrojë shërbime dhe/ose rrjet të komunikimeve elektronike dhe faciliteteve shoqëruese;
2. “Pajtimtar” është cilido që ka lidhur një kontratë me parapagesë ose post-paid me një operator që ofron shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun, për përfitimin e shërbimeve të ofruara.
3. “Operator dhënës” është operatori në rrjetin e të cilit numri i bartur ishte vendosur para bartjes;
4. “Operatori dhënës fillestar” është operatori të cilit AKEP i ka caktuar numra dhe seri numerike sipas Planit Kombëtar të Numeracionit në të cilat bëjnë pjesë numri/numrat e pajtimtarit.
5. “Operatori marrës” është operatori në rrjetin e të cilit numri i bartur vendoset pas bartjes;
6. “Bartje” është procesi i transferimit të numrit të një pajtimtari nga rrjeti i operatorit dhënës në rrjetin e operatorit marrës;
7. “Eksportim” është procedura që ndërmerr operatori dhënës në mënyrë që të mundësojë bartjen e numrit nga rrjeti i tij në rrjetin e operatorit marrës;
8. “Importim” është procedura që ndërmerr operatori marrës në mënyrë që të mundësojë bartjen e numrit nga rrjeti i operatorit dhënës në rrjetin e tij;
9. “Numër i bartur” është numri telefonik të cilit pas bartjes, i ofrohet shërbim nga një operator i ndryshëm nga operatori dhënës.
10. “Numër gjeografik” është një numër kombëtar, i cili i përket një zone gjeografike të caktuar siç është përkufizuar në nenin 8 të rregullores për numeracionin;
11. “Numër i lëvizshëm” është një numër kombëtar, i përdorur nga pajtimtarët e rrjeteve të komunikimeve të lëvizshme, siç është përkufizuar në nenin 9 të rregullores për numeracionin;
12. “Rregullorja për numeracionin” është rregullorja “Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit”.
13. “All call query” (ACQ) -kërkimi për çdo thirrje” është metodë që përcakton se rrjeti origjinues, para vendosjes së çdo thirrje, përcakton rrjetin në të cilin numri i thirrur është i vendosur aktualisht duke kërkuar një pasqyrë lokale të bazës së të dhënave referencë të centralizuar

14. “Baza e të dhënave referencë të centralizuar” është një bazë të dhënash për të bërë të mundur bartjen e numrit dhe për të mbajtur informacionet për të bërë rrugëzimin e të gjithë numrave të bartur.
15. “Ofruesi i bazës së të dhënave referencë të centralizuar” (këtu e më poshtë Ofruesi) është personi juridik i cili është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, i zgjedhur nga AKEP për të ofruar bazën e të dhënave referencë të centralizuar.
16. “Baza e të dhënave lokale pasqyrë” është një bazë aktive të dhënash e vendosur tek operatorët, që përmban të dhënat e nevojshme për transferimin e thirrjeve tek numrat e bartur.

Neni 3 Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet vetëm për bartjen e numrave gjeografikë (bartje fiks-në-fiks) dhe numrave të lëvizshëm (bartje numër i lëvizshëm-në-numër i lëvizshëm);
2. Një numër gjeografik mund të bartet në rrjetin e operatorit marrës, vetëm nëse përdorimi i tij pas bartjes do të jetë në përputhje me rregulloren për numeracionin, në veçanti me dispozitat për lidhjen mes kodit kombëtar të destinacionit të numrit gjeografik dhe vendndodhjes fikse ku do të përdoret (neni 8 pika 5 e rregullores për numeracionin). Nuk është e domosdoshme që operatori marrës të ofrojë shërbim telefonik në adresën e njëjtë siç është ofruar nga operatori dhënës.
3. Një numër i lëvizshëm mund të bartet vetëm në rrjete të komunikimit të lëvizshëm.
4. Portabiliteti i numrit ndjek parimin e neutralitetit të teknologjisë. Nuk kërkohet që operatori dhënës dhe operatori marrës të përdorin teknologjinë e njëjtë për të ofruar shërbime publike telefonike.
5. Vetëm numrat të cilat janë subjekt i një kontrate me pajtimtarin mund të barten. Kontrata mund të jetë me parapagesë ose post-paid.
6. Aplikimi teknik i portabilitetit të numrit nuk parandalon zgjerimin e mëvonshëm të fushëveprimit të dispozitave ligjore për portabilitetin e numrit. Baza e të dhënave referencë e centralizuar do të mund të mbështesë bartjen e të gjithë numrave të planit kombëtar të numeracionit.

Kapitulli II

Të drejtat dhe detyrimet në kontekst të portabilitetit të numrit

Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet e pajtimtarit

1. Portabiliteti i numrit është e drejtë e pajtimtarit në marrëdhëniet e tij kontraktore me operatorin dhënës dhe atë marrës. Pajtimtari ka të drejtën të mbajë numrin kur ndryshon operatorët.
2. Një pajtimtar mund të bartë numrin duke nënshkruar kontratë me operatorin marrës dhe duke shprehur dëshirën të anulojë kontratën me operatorin dhënës dhe të bartë numrin. Kontrata e vjetër dhe ajo e reja mund të jenë me parapagesë ose post-paid.

3. Veprimi i bartjes anulon kontratën mes pajtimtarit dhe operatorit dhënës, por nuk i përfundon detyrimet kontraktore të cilat ekzistojnë para bartjes. Në veçanti, pajtimtari është i detyruar të paguajë (shlyejë) çdo detyrim që del nga kjo kontratë.
4. Asnjë kontratë mes pajtimtarit dhe operatorit nuk mund përjashtojë të drejtën e pajtimtarit për të bartur numrin. Klauzolat e kontratës të cilat përjashtojnë ose kufizojnë të drejtën e pajtimtarit për të bartur numrin janë të pavlefshme.
5. Kontrata mes pajtimtarit dhe operatorit dhënës mund të parashikojë që pajtimtari duhet të paguajë kompensim për përfitime të caktuara nga kontrata, siç janë uljet ose telefonat e subvencionuar, nëse pajtimtari anulon kontratën para përfundimit të kohëzgjatjes minimale të kontratës. Kohëzgjatja minimale e kontratës dhe shuma e kompensimit duhet të përcaktohet në kontratë. Kohëzgjatja e kontratës duhet të jetë jo më pak se 6 (gjashtë) muaj.
6. Kontrata mes pajtimtarit dhe operatorit mund të parashikojë që pajtimtari të paguajë një tarifë për eksportimin e numrit. Kjo tarifë mund të mbulojë koston e ndryshimit mes anulimit të zakonshëm të kontratës dhe anulimit lidhur me eksportimin e numrit. Kosto e cila mbulohet nga operatori marrës nuk paguhet nga pajtimtari. Tarifa për eksportimin e numrit nuk duhet të jetë më e lartë se 600 Lek (me TVSH).

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e operatorit dhënës

1. Të gjithë operatorët të cilët përdorin numra gjeografikë ose të lëvizshëm duhet të mbështesin sipas përcaktimit të procesit të bartjes në kapitullin IV të kësaj rregulloreje, realizimin e eksportimit të këtyre numrave.
2. Detyrimi për të eksportuar numrat sipas kërkesës bazohet në parimin e paanshmërisë teknologjike dhe nuk varet nga teknologjia e përdorur nga operatori dhënës. Operatori dhënës nuk është i detyruar të konsiderojë nëse pajtimtari mund të përdorë pajisjet e njëjta në rrjetin e operatorit marrës.
3. Operatori dhënës nuk është i detyruar të eksportojë numrin para se ky numër të jetë subjekt i kontratës së parapaguar ose post-paid me pajtimtarin ose para se pajtimtari të pranojë thirrje hyrëse në atë numër.
4. Operatori dhënës nuk është i detyruar të eksportojë një numër pasi kontrata për këtë numër të ketë përfunduar dhe numri të jetë çaktivizuar përgjithmonë për të pranuar thirrje hyrëse.
5. Operatori dhënës është i detyruar të eksportojë numrin edhe kur kontrata është anuluar, por anulimi do të hyjë në efekt në të ardhmen (p.sh. për shkak të kohëzgjatjes minimale të kontratës), për sa kohë që numri mund të përdoret për të pranuar thirrje hyrëse. Nëse një numër është çaktivizuar vetëm përkohësisht (p.sh. sipas sanksioneve të kontratës për mos pagesë), operatori dhënës është përsëri i detyruar të eksportojë numrin.
6. Operatori dhënës është i detyruar të rregullojë kriteret e eksportimit të numrit nga rrjeti i tij në kushtet ose kontratën e përgjithshme të biznesit. Nëse operatori dhënës mendon të vendosë një tarifë për eksportimin (neni 4 pika 6 e kësaj rregulloreje) ose një kompensim për anulimin e kontratës para kohëzgjatjes së përcaktuar minimale të kontratës (neni 4 pika 5 e kësaj rregulloreje), operatori dhënës duhet ta përcaktojë këtë në kontratë.
7. Operatori dhënës fillestar nuk mund të kthejë seri numerike në përdorim, të cilat kanë të paktën 1 (një) numër aktiv të bartur.

8. Me përfundimin e kontratës së një numri të bartur, operatori dhënës fillestar mbetet mbajtësi i të drejtës për përdorimin e numrit.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e operatorit marrës

1. Të gjithë operatorët të cilët përdorin numra gjeografikë ose të lëvizshëm duhet të mbështesin sipas përcaktimeve të procesit të bartjes në kapitullin IV të kësaj rregulloreje, realizimin importimit të këtyre numrave.
2. Operatorët marrës duhet që të mbështesin importimin e numrave së paku për shërbimet e përdorura nga shumica e pajtimtarëve të tyre. Operatorët marrës nuk janë të detyruar të mbështesin importimin e numrave në shërbimet e tyre eksperimentale, provat në terren, ose në shërbimet të cilat përdoren vetëm nga një numër i vogël i pajtimtarëve.
3. Operatorët marrës janë të detyruar të sigurojnë që përdorimi i numrit pas importimit është në përputhje me rregullat për përdorimin e numrave të rregullores për numeracionin.
4. Operatori marrës është i detyruar të rregullojë kriteret e importimit të numrave në rrjetin e tij si dhe të gjitha kostot e mundshme ose kufizimet në kushtet ose kontratën e tyre të përgjithshme të biznesit.
5. Operatori marrës është i detyruar t'i njoftojë çdo numri që thërret një numër të bartur, nëpërmjet një mesazhi zanor, sms, ose mesazh i shkruar që del në telefonin e thirrësit, përpara kryerjes së thirrjes në kohën më të shkurtër të mundshme, faktin që ky numër është mbartur dhe operatorin ku është bartur.

Neni 7

Rrugëzimi i thirrjeve të numrave të bartur

1. Të gjithë operatorët e rrjeteve publike telefonike ose shërbimeve telefonike, të disponueshme për publikun, duhet të mbështesin rrugëzimin e thirrjeve në numra të bartur gjeografikë dhe të lëvizshëm. Mënyra e përzgjedhur e rrugëzimit është “all call query-kërkimi për çdo thirrje”.
2. Kur një thirrje rrugëzohet nëpërmjet shumë rrjeteve, operatori pasardhës është i detyruar të sigurojë që thirrja është rrugëzuar në rrjetin e duhur:
 - a) Në rast të shërbimeve të (para)zgjedhjes së bartësit, operatori i cili ofron shërbimin e (para)zgjedhjes së bartësit;
 - b) Në rast të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, operatori i parë në Republikën e Shqipërisë i cili merr thirrjen ndërkombëtare dhe
 - c) Në të gjitha rastet e tjera, operatori në rrjetin e të cilit është origjinuar thirrja.
3. Operatorët mund të përmbushin detyrimet e vendosura nga pikat 1 dhe 2 të këtij neni vetë ose nëpërmjet të marrëveshjeve kontraktore me operatorin tranzitues.
4. Për çdo numër të bartur, baza e të dhënave referencë e centralizuar ofron informacion në rrjetin në të cilin numri i bartur ka qenë i vendosur para bartjes, në rrjetin në të cilin numri vendoset pas bartjes si për datën dhe orën e saktë kur bartja do të bëhet efektive. Të gjithë operatorët të cilët rrugëzojnë thirrje tek numrat gjeografikë dhe të lëvizshëm do të

sinkronizojnë bazën e të dhënave lokale pasqyrë me bazën e të dhënave referencë të centralizuar së paku çdo gjashtë orë. Operatorët do të minimizojnë periudhën kohore gjatë së cilës ata rrugëzojnë thirrjet në rrjetin e gabuar.

Kapitulli III

Baza e të dhënave referencë e centralizuar

Neni 8

Dispozitat e përgjithshme

1. Baza e të dhënave referencë e centralizuar do të mbështesë procesin e bartjes dhe rrugëzimin e thirrjeve në numrat e bartur:
 - a) Të gjitha mesazhet standarde mes operatorëve në procesin e bartjes siç janë përshkruar në kapitullin IV të kësaj rregulloreje do të shkëmbehen nëpërmjet bazës së të dhënave referencë të centralizuar. Bashkëveprimi i drejtpërdrejtë mes dy operatorëve do të jetë i domosdoshëm vetëm nëse një problem nuk mund të zgjidhet nëpërmjet të mesazheve të standardizuara (neni 17 i kësaj rregulloreje).
 - b) Për secilin bllok të numrave gjeografikë dhe të lëvizshëm baza e të dhënave referencë e centralizuar do të ofrojë informacion të përditësuar lidhur me rrjetin e operatorit në të cilin blloku i numrave është aktualisht i vendosur.
 - c) Për secilin numër të bartur baza e të dhënave referencë e centralizuar do të ofrojë informacion të përditësuar për:
 - aa) rrjetin në të cilin numri është vendosur para bartjes,
 - bb) rrjetin në të cilin numri është ose do të jetë i vendosur pas bartjes
 - cc) datën dhe orën e saktë kur bartja bëhet efektive.
2. “Ofruesi” do të ofrojë ndërfaqe elektronike nëpërmjet të cilave mesazhet standarde siç është përshkruar në kapitullin IV të kësaj rregulloreje mund të shkëmbehen mes operatorëve dhe bazës së të dhënave referencë të centralizuar. Këto ndërfaqe do të mbështesin veprimin manual (p.sh. formularët e bazuar në internet) dhe gjithashtu transaksionet plotësisht të automatizuara. Ofruesi gjithashtu do të sigurojë një ndërfaqe elektronike nëpërmjet së cilës AKEP-i do të përditësohet me informacionin e referuar në pikën 1b) të këtij neni.
3. Të gjitha proceset e bazës së të dhënave referencë të centralizuar, të përshkruara në këtë rregullore do të jenë plotësisht të automatizuara dhe secili transaksion do të përfundohet normalisht në pak sekonda.
4. Të gjitha mesazhet do të transmetohen të mbrojtura. Dërguesi dhe marrësi i secilit mesazh do të identifikohet saktësisht dhe përmbajtja e mesazhit do të mbrohet nga ndryshimi dhe aksesimi i paautorizuar. Çdo transaksion do të regjistrohet për qëllim të identifikimit dhe përgjegjësisë së transaksionit.

Neni 9

Ofruesi i bazës së të dhënave referencë të centralizuar

1. “Ofruesi” do të jetë person juridik i cili është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë. Ofruesi do të jetë i pavarur nga të gjithë operatorët.

2. Sipas parimit të mosdiskriminimit “ofruesi” do të trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët si dhe do t’ju bëjë të njohur procesin e zhvillimit dhe mirëmbajtjes së bazës së të dhënave referencës të centralizuar..
3. “Ofruesi” do të drejtojë bazën e të dhënave referencë të centralizuar 24 orë në ditë në të gjitha ditët e vitit.
4. “Ofruesi” do të aplikojë praktikat më të mira të industrisë për të siguruar disponueshmërinë e vazhdueshme dhe integritetin e bazës së të dhënave referencë të centralizuar. “Ofruesi” do ti garantojë operatorëve disponueshmërinë e të gjitha funksioneve të bazës së të dhënave në të paktën 98.5% llogaritur gjatë vitit kalendarik dhe do të parashikojë kompensim të përshtatshëm në rast të dështimit për të arritur këtë nivel të shërbimit.
5. “Ofruesi” është i detyruar të zbatojë parashikimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave vetjake dhe privatësisë.

Neni 10

Mbikqyrja e ofruesit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar

1. AKEP-i do të zgjedhë ofruesin e bazës së të dhënave referencë të centralizuar nëpërmjet procedurës së prokurimit publik sipas parashikimeve të caktuara për këtë qëllim.
2. AKEP përpara fillimi të procedurës së përzgjedhjes së “ofruesit”, do të publikojë termat e referencës të cilat kryesisht do të përmbajnë:
 - a) një përshkrim të shërbimeve që do të ofrohen, në veçanti: të zhvillojë specifikimet e detajuara teknike të ndërfaqeve të bazës së të dhënave dhe protokolleve të komunikimit, të instalojë dhe administrojë “hardware” dhe “software” të nevojshëm,
 - b) kërkesat minimale për afatin kohor për publikimin e specifikimeve teknike, themelimin e bazës së të dhënave, ekzaminimit dhe fillimit të veprimit;
 - c) një përshkrim të dokumentacionit të cilin duhet ta paraqesin ofertuesit, në veçanti dokumentat të cilat vertetojnë identitetin juridik dhe pavarësinë nga operatorët, një përshkrim të zgjidhjeve të propozuara teknike, afatet kohore të garantuara nga tenderuesi, një plan biznesi për aktivitetin e ofrimit të bazës së të dhënave referencë të centralizuar dhe vlerësimet për detyrimet të cilat operatorët pjesëmarrës do të duhet ti paguajnë;
 - d) data dhe ora deri kur kërkesat mund të paraqiten dhe
 - e) kriteret për zgjedhje të cilat do ti përdorë AKEP-i.
3. AKEP-i vendos për zgjedhjen e “ofruesit”. AKEP përcakton të drejtat dhe detyrimet e ofruesit të përzgjedhur në përputhje me këtë rregullore.
4. AKEP-i do të anulojë vendimin për zgjedhjen e “ofruesit” para 5 (pesë) vjetëve pas datës së referuar në pikën 3 të këtij neni nëse vërteton se ofruesi nuk përmbush detyrimet që dalin kjo rregullore dhe vendimet e AKEP-it.
5. Jo më vonë se 3 (tre) vjet AKEP-i do të rishikojë nëpërmjet këshillimit publik nëse baza e të dhënave referencë e centralizuar ofrohet mjaftueshëm, nëse funksionimi duhet ndryshuar ose zgjeruar dhe nëse personat e tjerë juridikë janë të interesuar të ofrojnë bazën e të dhënave referencë të centralizuar.

Neni 11
Financimi i bazës së të dhënave referencë të centralizuar

1. AKEP do të mbulojë koston e investimit fillestar për themelimin e bazës së të dhënave dhe ndërfaqeve të saj, sipas parashikimeve në buxhetin e tij, i cili do të sigurohet nga pagesat që do të kryejnë operatorët.
2. “Ofruesi” do të llogarisë veçmas koston për mbështetjen e procesit të bartjes dhe koston për sinkronizimin dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave referencë të centralizuar me bazat e të dhënave lokale pasqyrë. Kosto do të shpërndahet përpjestimisht mes operatorëve pjesëmarrës.
3. Detyrimet mujore për bazën e të dhënave referencë të centralizuar do të bazohen në koston e ofruesit duke përfshirë marzhin e përshtatshëm të fitimit.
4. “Ofruesi” do të ofrojë për të gjithë operatorët një kontratë tip e cila përmban të njëjtat kushte kontraktuale.
5. “Ofruesi” do të rishikojë çdo vit kontratën e tij tip dhe ndryshimet e saj varësisht nga kostoja e llogaritur. Kontrata tip si dhe detyrimet duhet të miratohen me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP-it

Kapitulli IV
Procesi i bartjes

Neni 12
Dispozitat e përgjithshme

1. Procesi i bartjes është i bazuar në parimin “one-stop shopping”. Në mënyrë që të fillojë bartja e numrit, pajtimtari nënshkruan një kontratë me operatorin marrës dhe operatori marrës kontakton operatorin dhënës nëpërmjet bazës së të dhënave referencë të centralizuar. Nuk kërkohet nga pajtimtari të kontaktojë operatorin dhënës para bartjes.
2. Pajtimtari i cili ka nënshkruar një kontratë të mbart një numër me operatorin e ri do ta ketë të aktivizuar këtë numër jo më vonë se 24 orë, nga momenti i konfirmimit të dhënësit. Procesi i plote i bartjes se numrit duhet të realizohet brenda 3 ditëve pune.
3. Në çdo rast pajtimtari nuk mund të kërkojë bartjen e numrit më shumë se 90 ditë përpara.
4. Procesi i bartjes është i mbështetur nga baza e të dhënave referencë e centralizuar. Mesazhet mes operatorit marrës dhe operatorit dhënës shkëmbehen nëpërmjet bazës së të dhënave referencë të centralizuar.
5. Baza e të dhënave referencë e centralizuar ofron informacion autentik për procesin e bartjes. Procesi i bartjes përfundon kur baza e të dhënave referencë e centralizuar konfirmon përfundimin e tij.
6. Të gjitha komunikimet mes operatorëve dhe bazës së të dhënave referencë të centralizuar të cilat janë përshkruar në këtë kapitull do të jenë në format elektronik. Kur dispozitat në këtë kapitull përshkruajnë një procedurë si “të menjëhershme”, ato i referohen një procesi plotësisht të automatizuar që normalisht nuk zgjat më shumë se disa sekonda.

Neni 13

Procedura para kërkesës për bartje

1. Procesi për bartje nisët nga pajtímtari. Pajtímtari kontakton operatorin marrës dhe shpreh dëshirën për të lidhur kontratë dhe për të bartur numrin e caktuar.
2. Përveç informacionit të kërkuar nga neni 99 i ligjit 9918, operatori marrës është i detyruar ti ofrojë pajtímtarit të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:
 - a) që bartja do të përfundojë kontratën ekzistuese të pajtímtarit me operatorin dhënës, por nuk do ti përfundojë detyrimet kontraktore të cilat tashmë ekzistojnë;
 - b) që pajtímtari duhet ti paguajë operatorit dhënës të gjitha detyrimet e papaguara, duke përfshirë edhe tarifën për portabilitetin e numrit dhe/ose kompensimin nëse kontrata është anuluar para kohëzgjatjes minimale të kontratës së rënë dakord.
 - c) që pajtímtari duhet ti drejtojë të gjitha pyetjet lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara dhe pagesa të tjera të mundshme operatorit dhënës;
 - d) çdo detyrim që pajtímtari duhet ti paguajë operatorit marrës; dhe
 - e) nëse është e nevojshme, specifikimet teknike të ndërfaqes së rrjetit të operatorit marrës dhe nëse pajtímtari do të mund të përdorë pajisjet fundore ekzistuese;
3. Operatori marrës duhet të verifikojë identitetin e pajtímtarit sipas nenit 100 të ligjit 9918.
4. Operatori marrës do të vazhdojë me procesin e bartjes vetëm nëse pajtímtari nëpërmjet formularit në shtojcën e kësaj rregulloreje ka shprehur dëshirën e tij:
 - a) për të anuluar pjesërisht ose tërësisht kontratën me operatorin dhënës;
 - b) për të lidhur kontratë me operatorin marrës, dhe
 - c) për të bartur numrin/numrat nga operatori dhënës tek operatori marrës
6. Operatori marrës do të kontrollojë aplikimin e pajtímtarit sipas procedurave të zakonshme dhe do të vazhdojë me procesin e bartjes vetëm nëse ai dëshiron të lidhë kontratë me pajtímtarin dhe mund të importojë numrin e kërkuar. Nëse operatori marrës nuk e pranon ose e refuzon aplikimin e pajtímtarit brenda tri ditëve të punës, pajtímtari do të tërheqë aplikimin e tij.
7. Nëse operatori marrës drejton procesin e bartjes pa autorizimin e pajtímtarit, numri do të kthehet në rrjetin e operatorit dhënës dhe pajtímtari dhe operatori dhënës kanë të drejtë të kërkojnë kompensim për dëmin.

Neni 14

Kërkesa për bartje

1. Nëse operatori marrës ka përfunduar të gjitha fazat e përshkruara në nenin 13 të kësaj rregulloreje dhe është i gatshëm të nënshkruajë një kontratë me pajtímtarin dhe të importojë numrin, operatori marrës do të dërgojë kërkesën për bartje në bazën e të dhënave referencë të centralizuar.
2. Kërkesa për bartje përmban:
 - a) numrin i cili do të bartet;

- b) emrin e pajtimtarit;
 - c) datën e lindjes të pajtimtarit, nëse pajtimtari është individ, ose ID(letërnjoftim)
 - d) numrin NIPT të pajtimtarit, nëse pajtimtari është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - e) kodin e operatorit dhënës;
 - f) kodin e operatorit marrës dhe
 - g) datën dhe orën kur bartja do të bëhet efektive, ose një tregues që bartja do të bëhet efektive sa më shpejtë të jetë e mundur.
3. Baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë kontrollon saktësinë e kërkesës për bartje sa më shpejt të jetë e mundur, në veçanti nëse numri i cili do të bartet është numër gjeografik ose i lëvizshëm dhe nëse numri është saktësisht i vendosur në rrjetin e operatorit dhënës. Në rast se zbulohet ndonjë gabim, baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë i dërgon mesazh për gabimin operatorit marrës.
 4. Nëse baza e të dhënave referencë e centralizuar nuk zbulon ndonjë gabim, menjëherë regjistron kërkesën për bartje, cakton një numër referencë dhe konfirmon pranimin e kërkesës, duke përfshirë numrin e caktuar të referencës. Baza e të dhënave referencë e centralizuar gjithashtu menjëherë ri-drejtton kërkesën për bartje operatorit dhënës, duke përfshirë numrin e caktuar referencë.

Neni 15 **Përgjigja për bartje**

1. Kur operatori dhënës merr një kërkesë për bartje, do të kontrollojë:
 - a) nëse numri që do të bartet është subjekt i një kontrate aktive në rrjetin e operatorit dhënës dhe
 - b) nëse emri, data e lindjes ose (ID) dhe numri NIPT i regjistrimit të pajtimtarit i paraqitur në kërkesën për bartje përputhet me detajet e pajtimtarit në bazën e të dhënave të operatorit dhënës.
2. Pas ekzaminimit, operatori dhënës do të dërgojë përgjigjen për bartje në bazën e të dhënave referencë të centralizuar. Përgjigja për bartje përmban:
 - a) numrin referencë të këtij procesi të bartjes;
 - b) një tregues nëse është përgjigje pozitive ose negative;
 - c) në rast të përgjigjes negative, një tregues lidhur me arsyen e refuzimit të kërkesës për bartje, e cila mund të jetë vetëm një nga arsyet e mëposhtme:
 - aa) kërkesa për bartje nuk mund të lexohet ose ka ndonjë gabim tjetër lidhur me specifikimet teknike të kërkesës për bartje;
 - bb) numri që do të bartet nuk është i vendosur në rrjetin e operatorit dhënës;
 - cc) numri i cili do të bartet nuk është subjekt i një kontrate aktive;
 - dd) emri i pajtimtarit i paraqitur në kërkesën për bartje nuk përputhet me emrin e pajtimtarit në bazën e të dhënave të operatorit dhënës;

- ee) data e lindjes ose (ID) së pajtimtarit e paraqitur në kërkesën për bartje nuk përputhet me datën e lindjes ose (ID) së pajtimtarit në bazën e të dhënave të operatorit dhënës; ose
- ff) numri NIPT i pajtimtarit i paraqitur në kërkesën për bartje nuk përputhet me numrin NIPT të regjistrimit të pajtimtarit në bazën e të dhënave të operatorit dhënës.

Operatori dhënës nuk do të dërgojë përgjigje negative për asnjë arsye tjetër përveç këtyre gjashtë arsyeve të përmendura më sipër.

3. Të gjithë operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike me më shumë se 100,000 pajtimtarë do të aplikojnë procesin e plotë të automatizimit për të ekzaminuar kërkesat për bartje. Për këta operatorë, koha mes marrjes së kërkesës për bartje dhe përgjigjes nuk do të jetë më e gjatë se 5 minuta në 90% të të gjitha rasteve të muajit kalendarik dhe jo më gjatë se 24 orë në 98% të të gjitha rasteve të vitit kalendarik.
 - a. Koha mes pranimit të kërkesës për bartje dhe përgjigjes, në rastin e kërkesës për bartje të mbi 100 numrave të një pajtimtari, nuk do të jetë jo më gjatë se 3 ditë pune.
5. Për operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike me më pak se 100,000 pajtimtarë, koha mes pranimit të kërkesës për bartje dhe përgjigjes nuk do të jetë më e gjatë se 6 orë pune në 90% të të gjitha rasteve të muajit kalendarik dhe jo më gjatë se 3 ditë pune në 98% të të gjitha rasteve të muajit kalendarik.
 - a. Koha mes marrjes së kërkesës për bartje dhe përgjigjes në rastin e kërkesës për bartje të mbi 100 numrave të një pajtimtari, nuk do të jetë jo më gjatë se 5 ditë pune.
6. Orari i punës është nga 8 deri 16 nga e hëna deri të premten me përjashtim të festave publike. Nëse orari i punës në një ditë përfundon para skadimit të kufirit prej 6 orëve të punës, pjesa tjetër e afatit kohor fillon në 8 të ditës pasardhëse.
7. Nëse operatori dhënës nuk e dërgon përgjigjen për bartje brenda 24 orëve sipas pikës 3 dhe tri ditëve të punës sipas pikës 4, baza e të dhënave referencë e centralizuar do të veprojë sikur të ketë pranuar përgjigje pozitive për bartje.

Neni 16

Konfirmimi për bartje

1. Kur baza e të dhënave referencë e centralizuar merr përgjigje pozitive për bartje, do të përcaktojë menjëherë kohën kur numri mund të bartet (koha e bartjes) dhe do të regjistrojë këtë informacion në bazën e të dhënave.
2. Baza e të dhënave referencë e centralizuar do të preferojë të zgjedhë kohën e bartjes në natën pasardhëse, përveç rasteve kur pajtimtari kërkon që bartja të realizohet më vonë. Afati kohor mes konfirmimit të bartjes dhe kohës së bartjes do të jetë jo më shumë se gjashtë orë në mënyrë që të gjithë operatorët të cilët rrugëzojnë thirrje të mund të sinkronizojnë bazat e tyre të të dhënave lokale pasqyrë.
3. Baza e të dhënave referencë e centralizuar i dërgon menjëherë konfirmimin për bartje operatorit dhënës dhe operatorit marrës. Konfirmimi për bartje është konfirmim autentik për përfundimin e procesit të bartjes. Përmban:
 - a) numrin referencë të këtij procesi të bartjes;

- b) numrin që do të bartet;
 - c) emrin e pajtimtarit,
 - d) kodin e operatorit dhënës;
 - e) kodin e operatorit marrës; dhe
 - f) datën dhe orën kur do të bëhet bartja.
4. Kur baza e të dhënave referencë e centralizuar merr përgjigje negative, do të ri-drejtojë menjëherë përgjigjen tek operatorit marrës. Në këtë rast procesi i bartjes ka përfunduar pa sukses dhe varësisht nga arsyet e dështimit operatorit marrës mund të fillojë një proces tjetër.

Neni 17 **Përshkallëzimi (Rishikimi)**

1. Çdo operator i cili përdor numra gjeografikë ose të lëvizshëm do të emërojë një person kontakti, i cili do të ketë një numër telefoni si dhe një adresë emaili, i cili do të jetë përgjegjës për rastet të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet mesazheve standarde elektronike të përcaktuara në këtë kapitull. Baza e të dhënave referencë e centralizuar do të ketë një faqe Intraneti me detajet e kontaktit të gjithë personave të kontaktit të operatorit.
2. Nëse kërkesa për bartje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet shkëmbimit të mesazheve standarde elektronike, personi i kontaktit i operatorit marrës do të kontaktojë drejtpërdrejtë personin e kontaktit të operatorit dhënës të diskutojë një zgjidhje të mundshme. Operatorët dhe ofruesi i bazës së të dhënave referencë të centralizuar do të përpiqen të gjejnë një zgjidhje që është në interes të pajtimtarit.
3. Nëse problemet e caktuara teknike ose operacionale përsëriten, operatorët dhe ofruesi i bazës së të dhënave referencë të centralizuar do të bashkëpunojnë në zgjerimin e specifikimeve teknike në mënyrë që të zgjidhet ky problem.
4. Mosmarrëveshjet të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet këtij procesi do të zgjidhen nëpërmjet mekanizmave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të nenit 120 të ligjit 9918.

Neni 18 **Sanksionet**

Në rastet e shkeljes së detyrimeve që rrjedhin prej kësaj rregulloreje, AKEP zbaton përcaktimet e neneve 135 dhe 137 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Kapitulli V **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

Neni 19 **Dispozitat kalimtare**

1. Dërgimi i mesazheve MMS (Multimedia Messaging Service) në ose nga numrat e bartur kërkohet që operatorët të realizohet jo më vonë se 9 muaj pas vënies në punë të bazës së të dhënave referencë të centralizuar

2. Baza e të dhënave reference e centralizuar duhet të themelohet dhe testohet jo më vonë se 3 (tre) muaj pas miratimit të ofruesit.
 - a. Operatorët me mbi 100.000 pajtimtarë janë të detyruar të aplikojnë automatizimin e plotë të procesit të bartjes, jo më vonë një muaj pas themelimit dhe testimit të bazës së të dhënave reference të centralizuar për importimin dhe eksportimin e numrave dhe rrugëzimin e thirrjeve.
 - b. Operatorët me nën 100.000 pajtimtarë janë të detyruar të fillojnë të përdorin bazën e të dhënave referencë të centralizuar për importimin dhe eksportimin e numrave dhe rrugëzimin e thirrjeve, jo më vonë se një muaj pas themelimit dhe testimit të bazës së të dhënave reference të centralizuar.
3. AKEP do të publikojë specifikimet teknike për zgjedhjen e ofruesit të bazës referencë të centralizuar, në mënyrë që operatorët të përgatiten për ndërtimin e bazës së të dhënave lokale.

Neni 20

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi datën e miratimit të saj nga Këshilli Drejtues.

Shtojca
Kërkesa për bartjen e numrit

Numri i telefonit që do të bartet:
Emri i pajtimtarit:
Data e lindjes ose (ID) (nëse pajtimtari është individ):
Numri NIPT (nëse pajtimtari është i regjistruar):
Numri i telefonit do të bartet nga rrjeti i (“operatori dhënës”):
Numri i telefonit do të bartet në rrjetin e (“operatori marrës”):
Data kur do të bëhet bartja: <input type="checkbox"/> brenda 3 ditëve pune ose <input type="checkbox"/> ____ . ____ . ____ data, muaji, viti

Unë, i nënshkruari, jam informuar si më poshtë:

- a) Bartje e një numri të telefonit do të thotë që numri i plotë (duke përfshirë edhe tri shifrat e para) transferohet nga rrejtja e një operatori (“operatori dhënës”) në rrjetin e një operatori tjetër (“operatori marrës”). Si pajtimtar i një shërbimi telefonik kam të drejtën të kërkoj bartjen dhe që të dy, operatori i vjetër dhe i ri janë të detyruar të mbështesin këtë proces. Pajtimtari kërkon bartjen nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti dhe paraqitjes së tij tek operatori marrës, i cili duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të bartur numrin.
- b) Kontrata ime ekzistuese me operatorin dhënës do të përfundojë në kohën kur bartja bëhet efektive, por bartja nuk do të përfundojë detyrimet ekzistuese kontraktore.
- c) Në veçanti, unë duhet ti paguaj operatorit dhënës të gjitha detyrimet e papaguara që dalin nga kontrata ime ekzistuese. Kjo mund të përfshijë tarifën për portabilitetin e numrit dhe/ose kompensimin nëse unë e anuloj kontratën para kohëzgjatjes minimale të kontratës të rënë dakord.
- d) Nëse kam ndonjë pyetje lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara dhe ndonjë pagesë tjetër të mundshme ndaj operatorit dhënës, këto çështje duhet ti sqaroj në kontakt të drejtpërdrejtë me operatorin dhënës para nënshkrimit të këtij dokumenti.
- e) Operatori marrës është i detyruar të më informojë lidhur me detajet e kushteve të kontratës sime të re, në veçanti lidhur me çdo detyrim që unë duhet ti paguaj operatorit marrës dhe nëse unë mund të përdor pajisjet ekzistuese në rrjetin e operatorit marrës.
- f) Nëse kam ndonjë pyetje tjetër lidhur me kushtet ose tarifën e kontratës së re, do ti sqaroj këto çështje në kontakt të drejtpërdrejtë me operatorin marrës para nënshkrimit të këtij dokumenti.

Deklaroj si më poshtë:

1. Aktualisht përdor numrin/numrat e përmendur të telefonit në rrjetin e operatorit dhënës dhe dëshiroj të anuloj kontratën me operatorin dhënës për këto numra.

2. Dëshiroj të nënshkruaj kontratë me operatorin marrës sipas kushteve kontraktore, kushteve dhe tarifave të përgjithshme të biznesit të cilat më janë paraqitur nga operatori marrës në dokumente të veçanta.
3. Dëshiroj që të dy operatorët të bashkëpunojnë dhe të bartin numrin/numrat e përmendur nga rrjeti i operatorit dhënës në rrjetin e operatorit marrës në kohën e kërkuar. Autorizoj operatorin marrës, që në emrin tim, të ri-drejtojë kërkesën time operatorit dhënës për anulimin e kontratës time ekzistuese për numrin/numrat e përmendur.

(Vendi dhe data)

(Nënshkrimi)

“RAPORTI I AKEP PAS KËSHILLIMIT PUBLIK PËR PORTABILITETIN E NUMRIT”

Pjesa e pare

“Portabiliteti i Numrit-Rregullore per Portabilitetin e Numrit”

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) ne zbatim te Vendimit nr. 931, date 06.08.2009, te Keshillit Drejtues, ka nisur proceduren e keshillimit publik per **Portabilitetin e Numrit**.

Ne perfundim te afatit prej 45 ditesh te percaktuar ne vendimin e mesiperem te KD, rezulton se ne adrese te AKEP jane paraqitur komente dhe mendime ne lidhje me **Portabilitetin e Numrit**, nga palet e interesuara.

Palet e interesuara ju kane dhene pergjigje pyetjeve te adresuara ne dokumentin e keshillimit publik si dhe kane bere komente e kane dhene opinione ne lidhje me Portabilitetin e Numrit, te cilat jane paraqitur te permbledhura ne vijim te ketij dokumenti, respektivisht :

- Pyetje për operatorët me më shumë se 100,000 pajtimtarë

Pyetja 1: A është e realizueshme për ju që të aplikohet një përgjigje plotësisht e automatizuar për kërkesat për barjte siç është propozuar në nenin 15 pika 3 të projekt rregullores? Nëse jo, ju lutem përshkruani në detaje pse kjo nuk do të ishte e realizueshme. Sa kohë do të ju duhej për të aplikuar programin e nevojshëm pasi specifikimet teknike të bëhen të disponueshme, dhe sa do të ishte kostoja për aplikimin e një procesi të tillë të automatizuar (në krahasim me një proces i cili do të kërkonte një veprim manual)?

- Pergjigjet per pyetjen 1:

A:

-Realizimi i nje sistemi automatik gjykohet i pamundur mbasi kriteret e vleresimit te situates se perdoruesve jane te shumellojshme si dhe per faktin qe ne cdo rast do te kerkohej nderhyrja manuale e punonjesve te operatoreve per marrjen e vendimeve dhe konfirmimin e bartjes si ne rastin kur A eshte dhenes ashtu edhe kur A eshte marres.

-Sugjerojme: a) Realizimi i procesit te bartjes duhet te kryhet mbasi te sigurohet shlyerja e plote e detyrimeve te prapambetura te perdoruesve qe kerkojne bartjen e numrit.
b) Rregullorja duhet te vleresoje drejt problemet specifike te perdoruesve qe kane programe tarifore hibride (post-paid dhe pre-paid)

B:

-Mendojme se eshte teknikisht i realizueshem aplikimi i nje pergjigjeje plotesisht te automatizuar per kerkesat per bartje sikurse propozohet ne nenin 15 pika 3 e projekt rregullores.

C:

-Nuk mund te zbatojme teknikisht nje zgjidhje plotesisht te automatizuar per shkak te mangesive ne sistemet ekzistuese kompjuterike. Kemi planifikuar te adoptojme nje system CRM (sistem per menaxhimin e marredhenieve me publikun) i cili do te vihet ne zbatim brenda nje periudhe dy vjecare. Shpenzimet per kryerjen e ketij permiresimi i kushtojne operatorit rreth 3 milion Euro.

-Sugjerojme: AKEP te planifikoje nje proces te implementimit te bartjes ne dy faza:

a)Faza fillestare- u krijon mundesine operatoreve te blejne dhe te vene ne zbatim sistemet e nevojshme per te bere te mundur teknikisht zbatimin e bartjes se automatizuar(rreth dy vjet). Nderkohe bartja do te mundesohet me anen e nje veprimi manual.

b)Faza perfundimtare- Fillimi i zbatimit te nje procesi bartje plotesisht i automatizuar.

Oendrimi i AKEP ne lidhje me pergjigjet per pyetjen 1.

AKEP mendon se realizimi i nje procesi plotesisht te automatizuar te mbartjes se numrit per Operatoret mbi 100 mije pajtimtare eshte i mundshem. Koha qe do te kene ne dispozicion operatoret per te bere pershtatjet e teknologjive nga momenti i publikimit te termave teknike dhe specifikimeve per ngritjen e bazes se te dhenave, deri ne zbatimin e portabilitetit eshte plotesisht e mjaftueshme.

Pyetja 2: A mund të gjenden grupe të caktuara të pajtimtarëve për të cilët përjashtimi nga procesi i shpejtë i bartje është i justifikuar, kjo pasi nuk është e mundur të kontrollohet statusi i këtyre pajtimtarëve nga një proces plotësisht i automatizuar (p.sh. pajtimtarët me një numër të madh të telefonave nën një kontratë të vetme)? Nëse po, si do ta përcaktonit këtë grup (ose këto grupe) të pajtimtarëve? Ju lutem përshkruani në detaje pse nuk është e mundur të eksportohen numrat e këtyre pajtimtarëve me një proces plotësisht të automatizuar dhe sa pajtimtarë do të ndikoheshin nga ky përjashtim.

Pergjigjet per pyetjen 2:

A:

-Pajtimtarët me nje numer te madh numrash telefonike ne perdorim nen nje kontrate te vetme si dhe grupet e perdoruesve perbejne nje nga rastet per te cilat trajtimi perjashtimor ne kuptim te kohes dhe proceseve te nevojshme per kryerjen e bartjes, eshte i domosdoshem.

B:

-Grupet e caktuara te pajtimtareve, te cilet mund te perjashtohen nga procesi i shpejte i bartjes jane grupi i pajtimtareve me kontrate me fatura te papaguara. Mendojme qe teknikisht nuk eshte e mundur barjta e numrave te ketyre pajtimtareve me nje proces plotesisht te automatizuar.

C:

-Rasti i pajtimtareve me nje numer te madh te numrave telefonike nen nje kontrate te vetme, eshte i pamundur qe te realizohet me ane te nje procesi teresisht te automatizuar. Nga ana formale juridike nje forme e tille abonimi e veshtireson shume procesin e bartjes qe zakonisht fillohet nga nje individ dhe jo nga pala kontraktuese (shoqeria qe ka lidhur kontraten).

Oendrimi i AKEP ne lidhje me pergjigjet per pyetjen 2.

AKEP mendon se procesi i mbartjes bulk eshte i realizueshem, pasi pala kontraktuese eshte nje, pra

shoqeria qe e ka lidhur kontraten dhe jo numrat pjese perberese te kesaj kontrate. Koha per te realizuar portimin e nje numri te madh te numrave telefonike (mbi 100) te te njejtit pajtimtar nuk duhet te jete e ndryshme nga ajo e zakonshme.

Palet kontraktuese mund te rregullojne kushtet e mbartjes bulk ne kontraten e pajtimit.

▪ Pyetje per operatorët me më pak se 100,000 pajtimtarë

Pyetja 3: A është e realizueshme për ju të aplikoni procesin e përgjigjes se kërkesave për bartje siç është propozuar në nenin 15 pika 4 e projekt rregullores? Nëse jo, ju lutem shpjegoni në detaje pse kjo nuk është e realizueshme?

Nuk ka komente

Pyetja 4: Sipas projekt rregullores, operatorët me më pak se 100,000 pajtimtarë nuk janë të detyruar të aplikojnë plotësisht procesin e automatizimit për t'ju përgjigjur kërkesave për bartje. Megjithatë, një proces i automatizuar mund të ishte më ekonomik se një proces manual. A mendoni të automatizoni procesin dhe sa do ti kushtonte një operatori, sipas vlerësimit tuaj, aplikimi i një procesi të tillë?

Pergjigjet per pyetjen 4:

Nuk ka komente

▪ Pyetje për të gjithë operatorët të cilët i rrugëzojnë thirrjet

Pyetja 5: A është i realizueshëm për ju aplikimi i bazës së të dhënave lokale pasqyrë të bazës së të dhënave referencë të centralizuar dhe të rrugëzoni të gjitha thirrjet dalëse sipas kësaj bazë të dhënash? Nëse jo, ju lutem përshkruani në detaje pse kjo nuk do të ishte e realizueshme. Sa kohë do të ju nevojitej të aplikoni programin e nevojshëm (pasi specifikimet teknike të jenë bërë të disponueshme)?

Pergjigjet per pyetjen 5:

A: -Aplikimi i bazes se te dhenave lokale pasqyre eshte i mundeshem te aplikohet, megjithese ka veshtiresi teknike. Keto veshtiresi konsistojne ne nevojën e implementimit te ndryshimeve ne nje numer te madh sistemesh si MSC, MSS, MGW, HLR, Platforma Prepaid, Platforma e perfitimit te sherbimeve si dhe domosdoshmerine e integritimit te bazes se te dhenave lokale me te gjithë sistemet e lartpermendur. Meqenese eshte nje process i komplikuar, per kohen e nevojshme mund te jepet gjykim vetem pasi te jene te disponueshme specifikimet teknike. Eksperienca e implementimit ne vende te tjera tregon per nje kohe jo me te shkurter se 18 muaj.

B:

-Mendojme se eshte i realizueshem teknikisht aplikimi i bazes se te dhenave lokale pasqyre te bazes se te dhenave referencete centralizuar dhe rrugesimi it e gjitha thirrjeve dalese sipas kesaj baze te dhenash.

C:

-Aplikimi i bazes se te dhenave lokale pasqyre te bazes se te dhenave reference te centralizuar eshte i zbatueshem, per sa kohe qe ekzistojne kapacitetet teknike per te mundesuar kete process.

Element i domozdoshem i ketij sistemi eshte ngritja e bazes se te dhenave lokale pasqyre dhe rrugesimi it e gjitha thirrjeve dalese drejt bazes se centralizuar. Konsiderojme se sistemi “all-call-query” eshte zgjidhja me e pershtateshme per ngritjen e Bazes se te Dhenave Reference te Centralizuar. Ky skenar eshte praktika me e pranuar ne vendet anetare te BE-se, por ka kosto te larta sidomos per operatoret e vegjel.

Qendrimi i AKEP ne lidhje me pergjigjet per pyetjen 5.

AKEP ashtu sic shprehen operatore aplikimi të dhënave lokale pasqyrë të bazës së të dhënave referencë te centralizuar eshte teknikisht i realizueshem. AKEP merr parasysh pjeserisht sygjerimin e operatoreve ne lidhje me afatet e aplikimit te bazave te dhenave.

Pyetja 6: A është i realizueshëm për ju përditësimi i bazës së të dhënave lokale pasqyrë çdo gjashtë orë (përveç rasteve të problemeve të përkohshme teknike)? Nëse jo, ju lutem shpjegoni pse ky interval kohor për përditësim nuk do të ishte i realizueshëm për ju dhe çfarë intervali kohor do të sugjeroni.

Pergjigjet per pyetjen 6:

A:

-Propozimi yne eshte qe perditesimi te behet nje here ne 24 ore.

B:

-Besojme se procesi i perditesimit te bazes se te dhenave lokale pasqyre cdo gjashte ore eshte i realizueshem

C:

-Konsiderojme se procesi i perditesimit te bazes se te dhenave lokale pasqyre cdo gjashte ore eshte teknikisht i realizueshem. Mbetemi te mendimit qe personi juridik qe do te administroje bazen e te dhenave reference qendrore duhet te kete pergjegjesine e garantimit te procesit te automatizuar, ne momentin qe teknikisht kjo gje do te realizohet dhe behet e zbatueshme.

Qendrimi i AKEP ne lidhje me pergjigjet per pyetjen 6:

AKEP mendon se eshte plotesisht e realizueshme përditësimi i bazës së të dhënave lokale pasqyrë çdo gjashtë orë.

Pyetja 7: A mendoni ti jepni detyrimin për të rrugëzuar thirrjet në përputhje me bazën e të dhënave referencë të centralizuar një rrjeti tranzit? Nëse po, a do të mund të rrugëzonte saktësisht thirrjet e importuara në rrjetin tuaj ose të eksportuara nga rrjeti juaj zgjidhja teknike si dhe rrjeti juaj tranzitues?

Pergjigjet per pyetjen 7:

A:

-Gjykojme se ky detyrim mund t'i jepet rrjetit tranzitues, megjithe veshtiresite teknike qe paraqet nje gje e tille si dhe kohen e nevojshme per implementimin dhe testimin. Rezervojme te drejten e vleresimit perfundimtar te kesaj ceshtje pas detajimit te zgjidhjes teknike te propozuar.

B:

-Mendojme se nuk eshte e nevojshme dhenia e detyrimit per te rrugezar thirrjet ne perputhje me bazen e te dhenave reference te centralizuar nje rrjeti tjetër.

C:

-Konsiderojme se nje pyetje e tille per operatorin ne fjale do te kishte kuptim vetem ne rastin kur nje operator rrjeti mobil virtual (MVNO) shfrytëzon rrjetin e B per te ofruar sherbime ndaj publikut.

Edhe nese tregu shqiptar do te kete operatore te tille ne te ardhmen, nje operator MVNO do te jete ne gjendje te perdore pasqyren lokale te operatorit me rrjetin e te cilit ofron sherbime ndaj publikut.

Ne cdo aspekt tjetër, nuk mund te parashikojme nje situatë tjetër ku rrugezon thirrjet nepermjet nje rrjeti tranzit, me perjashtim te thirrjeve nderkombetare qe rrugezohen nga “carrier-i” nderkombetar.

Qendrimi i AKEP ne lidhje me pergjigjet per pyetjen 7:

AKEP mendon se eshte plotesisht e realizueshme rrugëzimi i thirrjeve dhe nepermjet rrjeteve tranzite te numrave te portuara.

▪ Pyetje për të gjithë pjesëmarrësit

Pyetja 8: A jeni dakord që procesi i propozuar i bartjes mund të zbatohet nga të gjithë operatorët?

Pergjigjet per pyetjen 8:

A:

-Nuk jemi dakord me procesin e propozuar.

B:

-Jemi dakord qe ky proces te zbatohetnga te gjithe operatoret, dhe fillimisht per operatoret celulare

C:

-Konsiderojme se eshte absolutisht e rëndësishme qe te gjithe operatoret celulare ne treg te perdorin te njejtin process bartje. Nese do te ekzistonte mundesia per te zbatuar nje process bartje me me pak shpenzime per nje operator, kjo nuk mund t'i mohohej operatoreve te tjere ne treg.

“C” ka nevojë per kohe dhe investime te konsiderueshme per te mundesuar plotesisht zbatimin teknik te bartjes se automatizuar. Ky proces mund te konsiderohet i lehte per disa operatore dhe i pazbatueshem per disa te tjere. Perjashtimi nga procesi i automatizuar i bartjes i nje operatori (sipas numrit te abonenteve, etj.) do te perbente nje shtremberim te tregut te telefonise celulare, si dhe diskriminim te disa operatoreve te caktuar.

Mbeshtesim zbatimin e nje procesi te bartjes (i automatizuar teresisht ose pjesisht apo i automatizuar me faza te ndryshme kohore) qe eshte teresisht i njejte per te gjithe operatoret ne treg.

Qendrimi i AKEP ne lidhje me pergjigjet per pyetjen 8

AKEP ashtu sic u shpreh ne pikat e mesiperme, eshte per nje process mbartje te automatizuar per operatoret me mbi 100 mije pajtimtare.

Pyetja 9: A dëshironi të propozoni një proces tjetër të bartjes ose ndryshime në nenet e kapitullit IV të projekt rregullores? Ju lutem shënoni arësytet e propozimeve tuaja, në veçanti, çfarë vështërsish teknike ose organizative mund të zgjidhen nëpërmjet propozimit tuaj.

Pergjigjet per pyetjen 9:

A:

-Nuk jemi dakord me opsionin “one-stop-shop” te sugjeruar nga AKEP. “A” eshte ne favor te caktimit te operatorit dhenes si inicues i procesit te bartjes. Kjo bazohet ne argumentet e me poshteme:

- permasat e medha te “bad debt” ne operatoret e telekomunikacioneve ne Shqiperi;
- shkalla e larte e informalitetit si dhe mungesa e sistemeve te sakta te adresimit;
- shkalla e larte e abonenteve ne grup, ku nen nje kontrate jane nje numer i madh individesh dhe detyrimet kontraktore jane me komplekse;
- operatori dhenes ka mundesi te vleresoje kerkesen dhe te kontrolloje sjelljen e abonentit;
- operatori dhenes ka mundesi te rivleresoje kontraten dhe te jape oferta te reja.

Sipas propozimit te “A”, abonenti kontakton operatorin marres vetem mbasi pajiset nga operatori dhenes me nje deklarate qe verteton se abonenti, bartes i numrit ka permbushur te gjitha detyrimet financiare dhe kontraktore qe ka me kete te fundit.

B:

-Jemi shprehur dakord edhe ne keshillimin e meparshem publik per portabilitetin e numrit lidhur me procesin e bartjes. Perseri jemi dakord me procesin e propozuar te bartjes duke perfshire: procedurat, kerkesat, pergjigjen per bartjen, komfirmimin, kohen e bartjes, etj., te cilat jane ne perputhje me propozimin tone.

C:

-Konsiderojme se procesi i bartjes se automatizuar mund te kryhet dhe zbatohet vetem pasi te jene bere investimet e nevojshme ne sistemet e saja te operimit (shif. pergjigjen e pyetjes 1). Ne momentin qe flasim implementimi i nje sistemi teresisht te automatizuar te bartjes eshte teknikisht i pamundur per “C”.

Konsiderojme se do te ishte e udhes qe ne nje faze te pare te zbatimit te procesit te bartjes se numrave celulare, te zbatohet nje menyre e perpunimit manuale. Kjo faze mund te zgjase 18 deri ne 24 muaj. Gjate kesaj kohe do te kryheshin investimet e duhura per zbatimin e sistemit CRM dhe permirosimin e sistemeve te operimit ne pergjithesi. Mbas fazes se pare do te ishim gati per te zbatuar nje proces te bartjes se numrit plotesisht te automatizuar. Rregullorja mund te caktonte edhe nje afat maksimal per zbatimin e fazes se dyte te projektit, diku rreth 6 muaj pas fazes se pare. Pra projekti per zbatimin e procesit te automatizimit te plote te bartjes do te kerkonte rreth 30 muaj, duke filluar nga muaji Tetor 2009.

Qendrimi i AKEP ne lidhje me pergjigjet per pyetjen 9:

AKEP sic eshte shprehur edhe me lart mendon se procesi i mbartjes i zgjedhur “all call query” eshte nder me te suksesshmit e aplikuar edhe ne vendet e tjera.

▪ Pyetje për çështjet e detyrimeve të pashlyera

Pyetja 10: A jeni dakord se rreziku nga detyrimet e pashlyera të pajtimtarëve pre-paid nuk ekziston, dhe nuk ka arsye operationale ose teknike që numri të mos eksportohet menjëherë pas pranimit të kërkesës për bartje?

Pergjigjet per pyetjen 10:

A:

-Nuk jemi dakord me konstatimin e AKEP lidhur me mungesen e rrezikut te detyrimeve te pashlyera nga perdoruesit pre-paid. Kur aplikohen programme tarifore hybrid dhe sherbime Ekstra Kredit ekziston nje ekspozim i mos shlyerjes se detyrimeve financiare nga ana e perdoruesve.

Gjykojme se ne kete rregullore nuk duhet lejuar qe perdoruesi te kete mundesine e kerkimit te rimbursimit te shumave te perdorura nga llogaria e perdoruesit. Kjo mundesi do te veshtiresonte procesin dhe do zgjaste shlyerjen e ndersjellte edhe ne kuader te veprimeve kontabel dhe pasqyrimet te tyre edhe ne zbatim te legjislacionit fiskal. Per kete arsye gjykojme se edhe perdoruesit pre-paid bartja mund te autorizohet vetem pasi te jete certifikuar shlyerja e te gjitha detyrimeve ndaj operatorit.

B:

-Jemi dakord se rreziku nga detyrimet e pashlyera te pajtimtareve pre-paid nuk egziston, dhe nuk ka arsye operationale ose teknike qe te mos eksportohet menjehere pas pranimit te kerkeses per bartje

C:

-Konsiderojme se depozitat dhe kushtet e pergjithshme te kontratave nuk perbejne mbrojtje te mjaftueshme nga abonentet me detyrime te pashlyera, qe do te perdorin shpesh te drejten per te bartur numrat e tyre si nje menyre per t'u shpetuar shlyerjes se detyrimeve.

Qendrimi i AKEP ne lidhje me pergjigjet per pyetjen 10.

AKEP-i e konsideron se problemi mbi detyrimet e pashlyera është i mbivlerësuar. Në tregun e celularëve, më shumë se 90% e të gjithë kontratave janë të parapaguara pa asnjë rrezik nga detyrimet e pashlyera. Edhe kontratat post-paid, në mënyrë tipike parashikojnë që pajtimtarët duhet të paguajnë një depozitë dhe kanë një kufi për detyrimet e mundshme të pashlyera. Operatorët kanë mundësinë të menaxhojnë rrezikun e detyrimeve të pashlyera dhe ata i përdorin këto mundësi këtu më shumë se çdo vend tjetër European.

AKEP-i gjithashtu konsideron se portabiliteti i numrit është e drejtë e pajtimtarit dhe se ligji nuk vendos ndonjë marrëdhënie mes ushtrimit të kësaj të drejte dhe pagesave. Në kontratat post-paid, pajtimtari normalisht paguan një muaj pasi të ketë përdorur shërbimin.

Gjithashtu ne Rregullore kemi parashikuar edhe problemin e detyrimeve te pashlyera,si psh:

- Veprimi i bartjes së numrit anulon kontratën mes pajtimtarit dhe operatorit dhënës, por nuk i përfundon detyrimet kontraktore të cilat ekzistojnë para bartjes. Në veçanti, pajtimtari është i detyruar të paguajë çdo detyrim të pashlyer që del nga kjo kontratë.
- Në veçanti, unë duhet ti paguaj operatorit dhënës të gjitha detyrimet e papaguara që dalin nga kontrata ime ekzistuese. Kjo mund të përfshijë tarifën për portabilitetin e numrit dhe/ose kompensimin nëse unë e anuloj kontratën para kohëzgjatjes minimale të kontratës të rënë dakord. (shkeputur nga formulari i aplikimit për bartje) etj.

Problemi i bartjes ose jo te numrave me parapagese, sqarohet ne nenin 3 te Rregullores se propozuar:

3-Vetëm numrat të cilat janë subjekt i një kontrate me pajtimtarin mund të barten. Kontrata mund të jetë me parapagesë ose post-paid.

Pyetja 11: Lidhur me shlyerjen e detyrimeve të papaguara në fund të kontratave post-paid: a mendoni se ka ndryshim mes pajtimtarëve të cilët i anulojnë kontratat e tyre pa e bartur numrin dhe pajtimtarëve të cilët e bartin numrin?

Pergjigjet per pyetjen 11:

A:

-Konsiderojme te papranueshem vleresimin e AKEP qe ceshtja e detyrimeve te pashlyera te perdoruesve eshte e mbivleresuar, vecanerisht ne rastin e perdoruesve post-paid. Ky grup abonentesh realizon ne teresi nje perqindje me te larte te ardhurash se perdoruesit pre-paid.

Abonentet Post-Paid duhet te shlyejne te gjithë detyrimet qe kane me operatorin dhenes para se te kerkojne bartjen e numrit ne operatorin marres. Koha e propozuar nga ana jone per realizimin e procesit te bartjes, jep nje zgjidhje te kenaqeshme edhe ne kete problem.

B:

-Mendojme se nuk ka ndryshim ndermjet pajtimtareve te cilet i anullojne kontratat e tyre pa e bartur numrin dhe pajtimtareve te cilet e bartin numrin. Ne te dyja rastet kemi te bejme me nje abonent me detyrime te papaguara.

C:

-Ne rastin e pare kemi te bejme me debitore te keqij qe nuk i perdorin me sherbimet e operatorit celular dhe nuk shlyejne detyrimet e tyre. Ne rastin tjeter kemi te bejme me debitore te keqij qe jo vetem nuk shlyejne detyrimet e tyre ndaj operatorit celular, por i kerkojne ketij te fundit edhe qe te mundesoje bartjen e numrit tek nje operator tjeter. Asnje operator nuk do te deshironte qe te kryente nje sherbim ekstra per debitoret e tyre. Nese AKEP konsideron se nje koncept i tille mund te abuzohet nga operatoret dhenes per te refuzuar mundesine e bartjes, atehere futja e perkufizimit “debitor i keq” (referimi ndaj nje shume minimale te pashlyer nga pajtimtari) do te zgjidhte shume dilema.

Qendrimi i AKEP ne lidhje me pergjigjet per pyetjen 11:

AKEP mendon se trajtimi i abonentëve me detyrime të pashlyera është i parashikuar në kontratat e lidhura me operatorët. Në të gjitha rastet qofte nderprerje ose bartje pajtimtari është i detyruar të njohe detyrimet financiare që rrjedhin nga kontrata.

▪ Baza e të dhënave referencë e centralizuar

Pyetja 12: A jeni dakord me dispozitat e propozuara lidhur me bazën e të dhënave referencë të centralizuar në kapitullin III të projekt rregullores? Nëse jo, ju lutem jepni ndryshimet e sugjeruara dhe shpjegimin përkatës.

Pergjigjet per pyetjen 12:

A:

-Jemi te mendimit qe baza e te dhenave duhet te ofrohet per llogari te operatoreve dhe jo nga operoret. AKEP duhet te menaxhoje ngritjen dhe funksjonimin e dy bazave qendrore te te dheneave (nje per numrat gjeografike dhe nje per numrat e levizshem). AKEP duhet te zgjedhe ose caktoje administrator te menaxhimit te bazave qendrore te te dhenave nje subject te profilizuar ne fushen e menaxhimit te te dhenave, aktiviteti it e cilit eshte nen mbikqyrjen e AKEP. Subjekti i zgjedhur nga AKEP duhet te jete i detyruar te koordinoje te gjithë procesin e shkembimit te te dhenave me te gjithë ofruesit e Portabilitetit te Numrit, duke respektuar parimet e mosdiskriminimit, transparences dhe objektivitetit.

Rregullorja duhet te perfshije lidhjen e marreveshjeve dypaleshe per Nivelin e Sherbimit (SLA) ndermjet operatoreve publike te telekomunikacionit, te perfshire ne procesin e Portabilitetit te Numrit dhe subjektit qe ofron sherbimin e menaxhimit te te dhenave (shembuj-Maqedonia, Austria apo Greqia).

Nuk jemi dakord me skemen e ofruar nga AKEP per ofrimin e bazes qendrore te te dhenave ku operoret do te jene pjesemarres si aksionere. Kjo do te krijonte mundesine per konflikt interesi dhe do te veshtiresonte zgjidhjen e mos marreveshjeve midis pjesemarresve ne kete proces.

B:

-Jemi dakord me dispozitat e propozuara lidhur me bazen e te dhenave reference te centralizuar.

C:

-Konsiderojme se propozimi i AKEP per te urdheruar operoret qe te themelojne bashkarisht nje shoqeri qe do te menaxhoje bazen e te dhenave qendrore eshte i parealizueshem dhe nuk mbeshtetet ne praktiken e BE.

Pse operore te tjere qe do te perfitojne nga sistemi i bartjes se numrit nuk duhet te jene bashkethemelues dhe bashkefinansues te kesaj ideje te AKEP.

Riperserisim dhe theksojme qendrimin tone persa i perket organizimit te shoqerise qe duhet te ndertoje, operoje dhe mirembaje bazen kombetare qendrore te te dhenave, sic eshte deklaruar ne Keshillimin e I-re Publik:

- Baza kombetare qendrore e te dhenave duhet te ngrihet dhe te drejtohet nga nje pale e trete e pavarur me njohurite e duhura teknike dhe eksperience per nje projekt kaq kompleks dhe delikat;
- AKEP duhet te ndermarre te gjitha hapat perkates per perzgjedhjen e kesaj pale te trete nepermjet procedurave te tenderimit, te mbikqye procesin e ngritjes si dhe funksionimin e saj ditor;
- Financimi per procesin e ngritjes se bazes se te dhenave duhet te jepet nga AKEP. Si alternative, pala e trete mund te financoje vete ngritjen e bazes se te dhenave dhe me

pas te kompesoje investimin duke caktuar tarifa transaksionesh per operatoret cdo here qe kryhet nje procedure bartje

Qendrimi i AKEP ne lidhje me pergjigjet per pyetjen 12:

AKEP merr ne konsiderate sugjerimet e operatoreve dhe do te beje ndryshimet perkatese ne rregullore duke zgjedhur ofruesin e bazes se te dhenave nepermjet procedures perkatese se prokurimit publik nga ana e AKEP (kapitulli III i rregullores). Edhe per problemin e financimit te ofruesit te bazes se te dhenave AKEP do ta kryeje investimin fillestar me buxhetin e tij ndersa kostoja per mbeshtetjen e procesit te bartjes dhe sinkronizimit e mirembajtjes se bazes se te dhenave do te shperndahet perpjestimisht mes operatorëve.

▪ Pyetje të tjera për pjesëmarrësit

Pyetja 13: *Kapitulli I i projekt rregullores përmban përkufizimet dhe fushëveprimin e portabilitetit të numrit në fazën e parë të futjes. A jeni dakord me projekt rregulloren e propozuar? Nëse jo, ju lutem jepni ndryshimet e sugjeruara dhe shpjegimin përkatës.*

Pergjigjet per pyetjen 13:

A:

-Jemi dakord me Kapitullin e I-re, por kemi verejtje per nenin 3, pika 8. "A" eshte ne favor te zgjidhjes me database qendror, por vec per operatoret mobile dhe vec per operatoret fiks.

B:

-Ne parim jemi dakord me projekt rregulloren e propozuar, por sugjerojme se neni 3, pika 7 e Kapitullit I-re duhet te ndryshohet duke perfshire edhe dispozita per bartjen e shume numrave te te njejtimit pajtimtar me nje veprim te vetem (bartja bulk).

C:

-Konsiderojme se detyrimi per bartje te numrit duhet te behet i detyrueshem edheper operatoret MVNO. Per rrjedhoje perkufizimi i termit "operator" duhet te perfshije shprehimisht edhe kete koncept.

Konsiderojme se neni 3, pika 6 imponon nje standard te paligjshem dhe teper rendues per operatorin dhenes. Ky standard eshte i paligjshem sepse bie ne kundersiztim me Kodin Civil sipas te cilit kontrata lidhet me objekt te caktuar specifik dhe ky eshte nje element i ligjshmerise te kontrates. Kontrata lidhet per nje ose disa numra te caktuar specifikesht ne kontrate. Per rrjedhoje edhe kerkesa per zgjidhjen e kontrates dhe per bartjen e numrit duhet te percaktoje specifikesht nje ose disa nga numrat qe barten. Sipas rregullit te percaktuar nga AKEP (ne kundersiztim me praktiken europiane), kerkes per bartjen e nje numri ISDN automatikesht zgjidh edhe numrat e tjere ISDN. Ne kete rast konsiderojme se kerkesa per bartjen duhet te behet specifike per nje numer te caktuar dhe te mos sjelle zgjidhje automatike te numrave te tjere te kontrates.

Qendrimi i AKEP ne lidhje me pergjigjet per pyetjen 13:

AKEP mendon se zgjedhja (procedura e perzgjedhjes) e bazes se te dhenave reference te centralizuar do te kryhet njekoheshisht dhe databaze qendror do te ofroje si mbarjen e numrave per operatoret mobile dhe per operatoret fiks.

AKEP mendon se bartja numrave bulk (e shume numrave te te njejtit pajtimtar me nje veprim) eshte i mundshem dhe do te pasqyrohet ne ndryshimet ne kete rregullore.

AKEP mendon se nuk ka percaktim te ndryshem per operatoret MVNO apo te tjere. Ligji 9918 dt.19.05.2008 dhe rregullorja i konsideron si operatoret ofrues te rrjeteve dhe/ose sherbimeve.

AKEP gjithashtu pranon sugjerimin per qendrimin ndaj pajtimtareve ISDN per kete do te beje ndryshimet perkatese ne rregullore.

Pyetja 14: Kapitulli II i projekt rregullores percakton të drejtat dhe detyrimet e pajtimtarëve dhe operatorëve. A jeni dakord me projekt rregulloren e propozuar? Nëse jo, ju lutem jepni ndryshimet e sugjeruara dhe shpjegimin përkatës.

Pergjigjet per pyetjen 14:

A:

-Bazuar ne eksperiencat e implementimit te Portabilitetit te Numrave ne vendet europiane, i propozojme AKEP te marre ne konsiderate rastet e listuara me poshte, per mos plotesimin e te cilave operatori dhenes mund te refuzoje bartjen e numrit:

- o nje kerkese per portabilitetin e numrit e pa plotesuar,
- o kerkuesi nuk mund te idendifikohet,
- o dy kerkesa bartje per te njejtein numer,
- o numri nuk eshte objekt i nje sherbimi aktiv ofruar nga dhenesi,
- o nuk jane permbushur kushtet e kontrates se sherbimit,
- o nje detyrim financiar i pa paguar,
- o perdoruesi ka nje karte SIM te bllokuar,
- o aparati eshte i regjistruar si vjedhur,
- o arsye te sigurise kombetare,
- o veshtiresi teknike.

Sugjerojme percaktime me te sakta ne rregullore lidhur me komunikimin ndermjet operatoreve gjate procesit te bartjes.

B:

-Neni 4, pika 2 e Kapitullit te II-te, i jep te drejten e bartjes vetem nje numri te nje pajtimtari te caktuar. Mendojme se duhet te rregullohet dhe perfshihet ne projekt rregullore edhe bartja e disa numrave nga i njejt i pajtimtar

C:

-Neni 4.6: Konsiderojme se percaktimi i nje tarife maksimale te pagueshme nga pajtimtaret prej 600 Lek per cdo bartje eshte i papranueshem. Duhet marre ne konsiderate shpenzimet e operatoreve per zbatimin teknik te ketij projekti. Vetem pasi grupi i punes te kete percaktuar se cilat kosto te bartjes do te faktorizohen ne tarifen e bartjes dhe afersisht cili eshte niveli i ketyre shpenzimeve, mund te arrihet ne percaktimin se cila duhet te jete tarifa e bartjes.

-Neni 5.4: Konsiderojme se fjalia e dyte (ku percaktohet se nje numer duhet te bartet edhe pse nje kontrate do te zgjidhet me efekt ne te ardhmen- per shkak te kohezgjatjes minimale te kontrates) duhet te hiqet sepse kushti i kohezgjatjes minimale te kontrates eshte ne perfitim te operatorit dhe jo te pajtimtarit

-Neni 5.5: Konsiderojme se vendosja e tarifës së bartjes duhet thjesht të njoftohet me anë të një njoftimi publik për pajtimtarët ekzistues dhe të vendoset në kushtet e pergjithshme të shërbimit për pajtimtarët e rinj nga momenti që bartja e numrit bëhet e zbatueshme. Nderkohe, kushti për bartje para afatit minimal të kontratës duhet të hiqet, sepse ndryshe ekzistenca e afatit minimal nuk do të kishte asnjë efekt në praktikë.

-Neni 6.4: Konsiderojme se operatorët marrës shprehjen e të gjitha aspekteve procedurale, shpenzimeve dhe kushteve për bartjen e numrit, duhet ta bëjnë me anën e një njoftimi publik për pajtimtarët ekzistues, ndërsa për pajtimtarët e rinj pas zbatimit të bartjes së numrit do të bëhet me kushtet e reja të pergjithshme të shërbimit.

-Neni 7.3: Konsiderojme se kjo pikë duhet të njohe shprehimisht edhe mundësinë që operatorit tranzitues në bazë të kësaj marrëveshje të mund të caktojë një tarifë në lidhje me shërbimin tranzitues që i ofron operatorit, i cili nuk ka mundësi të plotësojë kushtet në pikat 1 e 2 të nenit 7.

Neni 9.4: Konsiderojme se baza e të dhënave qendrore duhet të mbahet e replikuar në 2(dy) vendndodhje të ndryshme gjeografike për të minimizuar problemin në rast avarie apo apo defektesh teknike në njërin nga vendndodhjet e bazës së të dhënave (geographic redundancy)

Qendrimi i AKEP në lidhje me përgjigjet për pyetjen 14:

AKEP mendon se një pjesë e komenteve të bëra për pyetjen 14 janë përfshirë në rregullore, kryesisht ato që kanë të bëjnë të dhënat e kërkesës për bartje. Në lidhje me dy kërkesat për bartje për të njëtin numër dhe të ndonjë ceshtje tjetër teknike, AKEP mendon se do të jenë pjesë e trajtimit të kërkesat specifike teknike të ofruesit të bazës së të dhënave.

AKEP në përcaktimin e tarifës për bartjen e numrit nga ana e pajtimtarit, është bazuar në tarifën e vendeve të Europës (raporti 14 i BE-së), dhe ka marrë për referencë tarifën deri në 600 leke (5Euro) për të shërbyer si faktor lehtësues për bartjen e numrit për pajtimtarin.

Akep mendon se të drejtat dhe detyrimet midis paleve (operatorit dhe pajtimtarit) në lidhje me pagesën dhe kushte të tjera të bartjes përcaktohen në kontratat përkatëse.

AKEP merr parasysh komentimin në lidhje me “geographic redundancy” dhe do ta marrë në konsideratë gjatë hartimit të specifikimeve teknike në përzgjedhjen e ofruesit.

Pyetja 15: Kapitulli V i projekt rregullores përmban dispozitat përfundimtare dhe kalimtare. A jeni dakord me projekt rregulloren e propozuar? A mendoni se dispozita të tjera kalimtare janë të nevojshme? Ju lutem jepni ndryshimet e sugjeruara (duke përfshirë afatet kohore për procesin kalimtar) dhe shpjegimin përkatës.

Përgjigjet për pyetjen 15:

A:

-Lidhur me themelimin dhe testimin e bazës së të dhënave mendojmë se periudha e vendosur prej 4 muajsh nuk është e mjaftueshme. Propozojmë një periudhë 12 mujore.

Persa i perket detyrimit te operatoreve per te derguar MMS ne/nga numrat e bartur, propozojme nje afat 1 vjecar pas aplikimit per portabilitetin per sherbimin "voice".

Jemi dakord me propozimin e AKEP per ngritjen e grupit te punes me pjesemarrjen e operatoreve per diskutimin e problematikes se bartjes se numrit.

B:

-Jemi dakord me Kapitullin V – Dispozitat Kalimtare dhe Perfundimtare te Projekt Rregullores si dhe me piken 4.a qe rregullon bartjen e shume numrave te te njejtit pajtimtar ne nje transaksion te vetem (bartja bulk).

C:

-Neni 19.1: Konsiderojme se neni 19 duhet te specifikoje qartazi se miratimi i ofruesit nenkupton kryerjen e te gjitha procedurave per themelimin e personit juridik, financimin e pershtatshem te tij, gjendjen e fondeve dhe pergatitjes per periudhen e zbatimit teknik. Periudha e zbatimit teknik ne vetvete ne kushtet manuale kerkon minimalisht 8 muaj per te garantuar zbatim te suksesshem te projektit, nderkohe qe ne kushtet plotesisht te automatizuara kerkon dy vjet.

-Neni 19.4: Kerkojme ngritjen e grupit te punes ku te diskutohen ceshtje teper te rendesishme rreth zbatimit te projektit te bartjes se numrit.

D:

-Per sa i perket Ofruesit te Bazes se te dhenave, **nuk jemi dakord** qe Ofruesi i bazes se te dhenave te krijohet **vetem** operoret me me shume se 100.000 pajtimtare

Projekt Rregullorja nuk percakton rregulla te qarta teknike per implementimin e portabilitetit por vetem afate. Kjo mund te krijoje liri veprimi dhe diskrecionalitet te larte ne implementimin e saj dhe per pasoje te penalizoje Operoret qe nuk administrojne bazen e te dhenave.

Projekt Rregullorja ben nje gabim te madh duke tentuar qe ta lere menaxhimin e ketij procesi ne duart e nje kompanie te re, qe krijohet prej operatoreve mobile aktuale. Kjo, jo vetem qe krijon shmangie te AKEP nga detyrimi ligjor qe i jep Ligji i Telekomunikacioneve qe te zbatoje procesin e portabilitetit, por tenton ta lere kete proces ne duart e paleve me interesa te kunderta.

Oendrimi i AKEP ne lidhje me pergjigjet per pyetjen 15:

AKEP mendon se periudha per procesin i themelimit dhe testimi te bazes se te dhenave do te jetë një ndër kriteret perzgjedhës për ofruesin e bazes se të dhenave referencë, ne rregullore ky afat është përcaktuar 3 muaj .

Detyrimi për automatizimin e plotë nga ana e operatoreve me mbi 100.000 pajtimtarë është i realizueshem brenda 1 muaji pas themelimit dhe testimi te bazes se te dhenave reference te centralizuar per importimin dhe eksportimin e numrave dhe rrugezimin e thirrjeve.

Kurse operoret me nen 100.000 pajtimtare jane të detyruar të fillojne të përdorin bazën e të dhenave referencë të centralizuar për imortimin dhe eksportimin e numrave dhe rrugëzimin e thirrjeve, jo më vonë se 1 muaj pas themelimit dhe testimi te bazes se te dhenave reference te centralizuar.